



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE

QENDRA E KUJDESIT DITOR PËR FËMIJË DHE TË RINJ ME AFTËSI TË KUFIZUARA

PROCEDURA E APLIKIMIT DHE VLERËSIMI

1. Procedura standarde e pranimit për fëmijët që përfitojnë shërbime ditore ose gjysmëditore (6 – 18 vjeç)

1.1. Parashtrimi i kërkesës:

- Prindi/kujdestari paraqet pranë bashkisë një kërkesë me shkrim për regjistrimin e fëmijës.
- Bashkëngjitur kërkesës dorëzohen:
 - Formular aplikimi;
 - Çertifikatë lindjeje e fëmijës;
 - Çertifikatë familjare;
 - Kartela mjekësore dhe/ose vërtetim nga mjeku specialist që konfirmon aftësinë e kufizuar;
 - Raporte psikologjike, logopedike, terapeutike (nëse ka);
 - Vërtetim nga Komisioni i Përcaktimit të Aftësisë së Kufizuar (KMCAP).

1.2. Vlerësimi dhe vendimmarrja:

Pas vlerësimit fillestar dhe vlerësimit të përshtatshmërisë nga Qendra e Kujdesit Ditor, rastet që vlerësohen të përshtatshme për t'u pranuar për përfitimin e shërbimeve referohen pranë **Komisionit Multidisiplinar Vendor**. Ky i fundit merr vendimin nëse fëmija do të pranohet për përfitimin e shërbimeve ditore ose gjysmëditore, bazuar në sa më poshtë:

- Intervista me prindin/kujdestarin;
- Vëzhgim i fëmijës;
- Analizë e dokumentacionit të paraqitur.

1.3. Vlerësimi i përshtatshmërisë:

Komisioni vendos nëse:

- Qendra është e përshtatshme për nevojat e fëmijës;
- Qendra ka kapacitet njerëzor dhe logjistik për të përmbushur nevojat;
- Fëmija ka aftësi të përfitojë nga programet edukative, rehabilituese, dhe sociale që ofron qendra.

Vlerësimi përfundimtar bëhet nga Qendra e Zhvillimit.

- Nëse fëmija pranohet, prindërit njoftohen dhe ftohen të nënshkruajnë një marrëveshje bashkëpunimi.
- Nëse fëmija nuk pranohet (p.sh. për shkak të mungesës së kapaciteteve ose nevojave shumë specifike), prindërit këshillohen dhe referohen në institucione alternative.

2. Procedura standarde e pranimi për të rinjtë që përfitojnë shërbime të specializuara me orë

2.1. Parashtrimi i kërkesës:

- Prindi/kujdestari ose vetë përfituesi i shërbimit paraqet në qendër një kërkesë me shkrim për regjistrimin e personit.
- Bashkëngjitur kërkesës dorëzohen:
 - Çertifikatë lindjeje e fëmijës ose kartë ID;
 - Kartela mjekësore dhe/ose vërtetim nga mjeku specialist që konfirmon aftësinë e kufizuar;
 - Raporte psikologjike, logopedike, terapeutike (nëse ka);
 - Vërtetim nga Komisioni i Përcaktimit të Aftësisë së Kufizuar (KMCAP).

2.2. Vlerësimi nga Qendra e Zhvillimit:

Grupi multidisiplinar bën:

- Intervistë me prindin/kujdestarin (sipas rastit);
- Vëzhgim të personit;
- Analizë të dokumentacionit të paraqitur.

2.3. Vlerësimi i përshtatshmërisë dhe vendimi:

Ekipi i Qendrës së Zhvillimit vendos nëse:

- Qendra është e përshtatshme për nevojat e personit;
- Qendra ka kapacitet njerëzor dhe logjistik për të përmbushur nevojat;
- Personi mund të përfitojë nga programet edukative, rehabilituese, dhe sociale që ofron qendra.